



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-63
3.3.2026
Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr.ark.01-3632/1 datë 22.8.2025, neni 24, paragrafi (5) të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.ark.01-6222/1 datë 12.12.2014, Njoftimin nga Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar për radiodifuzion Mitanski Vele SUPER RADIO Ohrid ShPKNJ P, nr ynë.ark.08-710/1 datë 24.2.2026, Deklaratën për ndërprerjen me transmetim të programit në radio nga themeluesi i vetëm/pronar i transmetuesit, nr.UZP 613/2026 dhe Deklaratë nga drejtuesi i transmetuesit nr.UZP 612/2026, të dyja nga 23.2.2026 dhe Konkluzionin, nr.ark.02-774/2 datë 2.3.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 9-të mbajtur më 2.3.2026, miratoi:

Aktvendim
për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar për radiodifuzion Mitanski Vele SUPER RADIO Ohrid ShPKNJ P.
2. Ky aktvendim botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë, dhe do të zbatohet pas pagesës së kryer të kompensimit të Lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-115 datë 7.9.2023 nga transmetuesi në pajtim me faturën e dhënë nga Agjencia vetëm për periudhën e punës, përkatësisht nga data 5.1.2026 deri më 23.2.2026.

A r s y e t i m

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (ShPK) për radiodifuzion Mitanski Vele SUPER RADIO Ohrid ShPKNJ P, është zotërues i lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-115 datë 7.9.2023 (me periudhë vlefshmërie nga data 5.1.2024 deri më 4.1.2027), që transmeton program nëpërmjet transmetuesi tokësor (Gorenicka Çuka 97.00 MHz) në nivel lokal, në zonën e komunës së Ohrid, shërbim programor radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm, në gjuhën maqedone.

Më 23.2.2026 ShPK për radiodifuzion Mitanski Vele SUPER RADIO Ohrid ShPKNJ P, në mënyrë elektronike, në e-mail adresën zyrtare (contact@avmu.mk) të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (ASHMA) u dorëzua Njoftim (nr,ynë ark.08-710/1 datë 24.2.2026), në lidhje me ndalimin e vlefshmërisë së Lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-115 datë 7.9.2023, ndaj të cilit si shtojcë dërgoi deklarata e nevojshme: Deklaratë

nga themeluesi i vetëm/pronar i ShPK për radiodifuzion Mitanoski Vele SUPER RADIO Ohrid ShPKNjP – Sasho Mitanoski (e noterizuar) nr.UZP 613/2026 datë 23.2.2026 dhe Deklaratë nga drejtuesi i transmetuesit – Jane Srefanov (e noterizuar) nr.UZP 612/2026 datë 23.2.2026. Në deklaratat themeluesi i vetëm/pronar dhe drejtuesi i transmetuesit deklaruan se ShPK për radiodifuzion Mitanoski Vele SUPER RADIO Ohrid ShPKNjP, përfshirë dhe datën 23.2.2026 ka ndërprerë me transmetim të programit në radio, gjithashtu dhe transmetuesi do t'i përmbushë detyrimet financiare ndaj Agjencisë, në lidhje me pagesën e kompensimit të Lejes për transmetim në radio (PA1 nr.08-115 datë 7.9.2023), për periudhën e punës, për të cilën Agjencia do të japë faturë të re.

Pas miratimit të këtij Aktvendimi, në pajtim me nenin 24, paragrafi (5) të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë të ShPK për radiodifuzion Mitanoski Vele SUPER RADIO Ohrid ShPKNjP, AShMA do t'i japë faturë të re, e cila do t'i referohet periudhës së punës, përkatësisht nga data 5.1.2026 deri më datë 23.2.2026, faturë e cila duhet të paguhet deri më 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së lejes. Paraprakisht Fatura e dorëzuar, nr.2026-100-0056 datë 12.1.2026 (nr ynë.ark.05-118/1 datë 12.1.2026) për kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio të ShPK për radiodifuzion Mitanoski Vele SUPER RADIO Ohrid SHPKNjP, për periudhën nga data 5.1.2026 deri më 4.1.2027, e dhënë nga AShMA do të ndalohej.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), leja për transmetim në radio ndalon së vlefshmi sipas ligjit me deklaratë me shkrim të zotëruesit me të cilin njoftohet Agjencia se ndërprehen me transmetim të programit në radio. Për ndalimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio sipas ligjit Këshilli nuk sjell vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja ndalon së vlefshmi sipas fuqisë ligjore (neni 85 paragrafi 2 të LSHMAAV).

Rrjedhimisht nga sa më sipër, duke pasur parasysh nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, me dorëzimin e deklaratave me shkrim të lartpërmendura, si dhe për shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj Agjencisë për kompensim të lejes nga transmetuesi, do të përmbushen kushtet ligjore për ndalim të vlefshmërisë së lejes sipas ligjit, nga ku Agjencia do të fshijë transmetuesin ShPK për radiodifuzion Mitanoski Vele SUPER RADIO Ohër ShPKNjP nga regjistri i radiodifuzerëve.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, neni 24, paragrafi (5) të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë, Njoftimin e ShPK për radiodifuzion Mitanoski Vele SUPER RADIO Ohrid ShPKNj, nr ynë.ark.08-710/1 datë 24.2.2026, Deklaratë për ndalim të programit në radio nga themeluesi i vetëm/pronar i transmetuesit, nr.UZP 613/2026 dhe Dekrata nga drejtuesi i transmetuesit nr.UZP 612/2026, të dyja nga data 23.2.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-774/2 datë 2.3.2026, u miratua aktvendim si në dispozitiv, i cili hyn në fuqi menjëherë, dhe do të zbatohet pas pagesës së kryer të kompensimit të lejes në llogari të Agjencisë nga transmetuesi, në pajtim me pikën 3 të këtij aktvendimi.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.